



Muamer SADIKU



Qendra për Kulturë - Gostivar  
Центар за култура - Гостивар

Muamer Sadiku  
Муамер Садикү

*Poetika e vertikales*  
*Вертикална поетика*



*Gostivar / Гостивар 2015*

Skulptori, **Muamer Sadiku**, paralelisht ka kultivuar skulpturën figurative konkrete, por, edhe atë abstrakte. Duke mos i braktisur format realiste, të cilat vijjnë në shprehej në disa projekte ku dominon skulptura realiste monumentale me karakter publik, me të njëjtin përkushtim skulptori ka realizuar edhe punime që e tejkalojnë natyrën e lejueshmërisë vizuale. Një vend të posaçëm në krijimtarinë e tij zënë figurat e stilizuara dhe të sintetizuara skulpturale. Përcaktimin e këtyllë autori e shpreh edhe te cikli më i ri i punimeve të tij.

Në këtë cikël, i cili në një far mënyre është vazhdimësi e projektit të magistraturës, autori dëshmon afinitet në përcjelljen e linjës së transformimit të figurës. Punimet paraqesin projeksione tematike të shprehura si plastikë e plotë me karakter mobil. Sidomos, vjen në shprehja ndjeshmëri ndaj përpunimit të jashtëm të skulpturave, në të cilat dominojnë sipërfaqet mat, si një dimension i intimitetit tematik. Shumica e punimeve skulpturale paraqesin ndërlidhje simetrike midis tyre, ndaj dhe ato në hapësirë mund të qëndrojnë në çift njëra me tjetrën.

Ato janë realizime konkrete skulpturale që dëshmojnë vazhdimësinë e gjuhës së njohur të këtij krijuese. Kërkimet e tij krijuese autori i ka përqendruar në përcaktimin formave shprehëse skulpturale. Në aspektin figurativ ai vazhdon tu mbetet besnik formave të mbyllura të cilat zakonisht përdoren nëpër hapësirat tredimensionale, sidomos duke e kultivuar formën vertikale si njërën nga linjat themelore orientuese. Orientimi vertikale - nënkupton rritjen, madhështinë dhe shpirtëroren. Te disa realizime skulpturale dukshëm vjen në shprehje asociacioni i erotizmi si motiv në vete.

Në aspekt të dorëshkrimit duket se autori shërbehet me përvoja të disa rrymave (post)moderne duke krijuar një buqetë stilistik. Realizimet e modeluara përbëjnë shprehje kubo-abstrakte, të transformuar në figura të simplifikuara cilindrike, por të përcjella edhe me sekuenca të ansamblazhit të përshkruara edhe nga premisa të simbolizmit asociativ. Por shikuar nga një këndvështrim post-modern, këto forma metaforike sikur tentojnë edhe drejt një varianti të ekspresionizmit abstrakt, duke përkujtuar në arketipin në një sërë skulpturash modusin e totemit.

Skulpturat e realizuara të këtij cikli janë me përmasa të vogla dhe janë të përshtatshme për ambientet e mbyllura, ose thënë ndryshe, autori sjellë skulptura enterierësh. Por të njëjtat janë paramenduar në atë mënyrë që mund të gjejnë zbatim edhe nën qiell të hapur dhe atë me dimensione (mbi)natyrore. Format skulpturale kanë prapavijën antropomorfe, zoomorfe, ku vjen në shprehje erotizmi i figurave.

Në aspektin teknik, duhet përkujtuar se skulptori Muamer Sadiku ka zbatuar një proces disa-hapësh deri në realizimin e këtyre skulpturave, duke përdor disa materiale të teknologjisë bashkëkohore, ku dominojnë ato sintetike, siç janë: stiropori, të derdhura në poliestër, por të shoqëruar edhe me shufra dhe fragmente armature prej metali (hekuri), copa tekstili, etj.

Вајарот, Муамер Садику, истовремено ја култивира конкретната фигуративна скулптура, но и таа апстрактната. Без напуштање на ралните форми, кои доаѓаат до израз на некои проекти каде доминира реално-монументалната скулптура со јавен карактер, со истата посветеност вајарот реализирал и дела кои ја надминуваат природата на дозволената визуалност. Едно значајно место на неговата творба завземаат стилизираните фигури и синтетизираните скулптури. Ваквото дефинирање авторот го изразува и во најновиот циклус на неговите дела.

Во овој циклус, кој на еден одреден начин е продолжение на магистарскиот труд, авторот ни ги докажува своите афинитети за следење на линијата од трансформацијата на фигурата. Делата прикажуваат тематски проекции изразени како потполна пластика со мобилен карактер. Особено доаѓа до израз чувствителноста кон надворешната обработка на скулптурата, во која доминираат матните површини, како една димензија на тематскиот интимитет. Поголемиот дел од скулптурите ја прикажуваат симетричната поврзаност помеѓу нив, отука тие можат во просторот да опстојат една до друга. Тие се конкретни вајарски реализации кои го докажуваат продолжетокот од препознатливиот говор на овој автор. Неговите креативни истражувања, авторот ги фокусира во утврдување на вајарската форма на изразување. Во ликовен аспект тој продолжува да биде верен на затворени форми кои обично се користат во тридимензионални простории, особено одгледувајќи ја вертикалната форма како една основна ориентациона линија. Вертикална ориентација- подразбира растот, величественоста и духовната големина. Во некои вајарски дела доаѓа до очигледен израз асоциацијата на еротизмот како посебен мотив.

Во аспектот на ракописот се гледа дека авторот се користи со искуствата од (пост)модерната рима создавајќи еден стилски букет. Реализираните моделации сочинуваат кубо-апстрактно изразување, трансформирани на цилиндрични симплифицирани фигури, но припратени и со секвенции од ансамблж опишан од премисата на асоцијативен симболизам. Но гледајќи и од пост-модерниот аспект, овие метафорични форми како да се обидуваат и кон вариантата на апстрактниот експресионизам, потсетувајќи на серија архетип скулптури во тотемски модус.

Реализираните скулптури од овој циклус се во мали димензии и се соодветни за затворени средини, или кажано на друг начин, авторот ни носи ентериерски дела. Но истите се осмислени на тој начин да можат да најдат имплементација и на отворено небо и тоа во (над)природни димензии. Вајарските форми имаат антропоморфна позадина, зооморфна, каде што доаѓа до израз еротичноста на фигурите.


Во технички аспект, треба да напоменеме дека Муамер Садику извршил еден процес од неколку-чекори до реализација на овие скулптури, употребувајќи некои материјали од современата технологија, каде што доминираат синтетичните материјали, како што се: стиропор, излеани во полиестер, но и пропратени со метална арматура (железо), делови од текстил, итн.







































## **MUAMER SADIKU**

Mr. Muamer Sadiku u lind më 10.08.1963 në Çegran të Gostivarit, Republika e Maqedonisë. Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje,

**1982** - kreu shkollën e mesme në gjimnazin „Pançe Popovski,, në Gostivar,

**1998** - diplomoi në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Fakulteti i Arteve - Dega e Skulpturës, në Tetovë.

**1998**- filloi studimet pasuniversitare në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Arteve në Degën e Skulpturës nën drejtimin e mentorit prof.ord. Agim Rudi,

**2002** – magjistroi në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Arteve në Degën e Skulpturës dhe mori thirrjen **"Magjistër i Skulpturës"**

Në vitin 2010 zgjedhet në thirrjen mësimore-profesionale docent për lëndët Skulpturë 1,2,3,4 , në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Fakultetin e Arteve, programi studimor-Arti Figurativ.

Në vitin 2013 zgjedhet në thirrjen mësimore-profesionale Prof. inordinar për lëndët Skulpturë 1,2,3,4, në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Fakultetin e Arteve, programi studimor-Arti Figurativ

### ***Ekspozita ndërkombëtare:***

2015- Galeria MC, Nju Jork

2009- Pallati ndërkombëtar – Korçë (çmimi i tretë Vangjush Mio)

2008- Ekspozita ndërkombëtare Kulen Vakuf - Bosnjë

### ***Ekspozitat personale (Përvoja profesionale):***

Në vitin 2000 fitoi konkursin për realizimin e skulpturës " Simboli i lirisë" në ish kampin e Çegranit në shenjë përkujtimi për refugjatët kosovar.

Në vitin 2002 bën realizimin teknik (koautor) të shtatores ,, VICTORY, në Prishtinë në dimensione mbi gjashtë metra.

Në vitin 2007 fiton konkursin për realizimin e shtatores së Fadil Nimanit ,, Komandant Tigri,, në Vaksince të Kumanovës.

Në vitin 2015 ekspozitë personale në Qendën për kulturë – Gostivar

### **Projektet: (Ekspozitat kolektive)**

2014 - Kolonia e Artit nderkombetar "Gostivari 2014"

2013 - Kolonia e Artit nderkombetar "Gostivari 2013"

2012 - Kolonia e Artit nderkombetar "Gostivari 2012"

2011- Pallati i Kulturës - Gostivar

2010- Salloni pranveror " Draodakum " në Gostivar, Maqedoni

2007- Muzeu i qytetit, në Strugë, Maqedoni

2006- " Çifte amam " Shkup, Maqedoni

2006- Pallati i kulturës, Gostivar, Maqedoni

2006- Salloni pranveror " Galeria e qytetit " Gostivar, Maqedoni

2005- Pallati i kulturës, Gostivar, Maqedoni

**Anëtar i asociacioneve:** Anëtar i komisionit për artin figurative në Ministrinë e Kulturës në R.M

- Anëtar i komisionit për qytetin e Kulturës në Ministrinë e Kulturës në R.M
- Anëtar i komisionit për nostrifikim të diplomave në Ministrinë e Arsimit në R.M
- Anëtar i komisionit për çmimin “11 Tetori”, në Ministrinë e Kulturës në R.M

**Koloni artistike**

- 2007 - Pjesëmarrës në koloninë Artistike mbarëkombëtare-Kodra e Diellit-Tetovë.
- 2008 - Pjesëmarrës në koloninë artistike-Strugë.
- 2011 - Pjesëmarrës në koloninë artistike – Kulen vakuf, Bosnje dhe Hercegovinë
- 2014 - Pjesëmarrës në Koloninë e Artistëve Figurativë në Shkup.

**Çmimet;**

- 2011 - Cmimin e parë - Shtatorja e Josif bageri-
- 2011- Cmimi i tretë - Shtatorja e Pjetër Bogdanit
- 2009 - Pallati ndërkombëtar - Korçë (Cmimi i tretë Vagjush Mio )
- 2014 - Çmimi për skulpturë “Shpërblimi i Nëntorit” SHAFM Draudacum.

**e-mail: muamer.sadiku@unite.edu.mk**

Botues : SHAFM Draudacum Gostivar

Për botuesin : Reshat Ameti, kryetar

Parathënja : Mixhait Pollozhani

Përkthimi : Lavdrim Memedi

Disenji i katalogut : Arjan Rufati

Fotografitë : Xhezair Rexhepi

Издавач : ЗЛУМ Драудацум Гостивар

За издавачот : Решат Амети, претседател

Предговор : Миџаит Положани

Превод : Љавдрим Мемеди

Графички дизајн : Арјан Руфати

Фотографии : Џезаир Реџеџи

Përkrahur nga Ministria e Kulturës së R. Maqedonisë  
Пожано од Министерство за Култура на Р. Македонија



